



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 317

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHPLLJEN E MOSZGJEDHSHMËRISË TË KANDIDATIT TË RADHËS NË LISTËN SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM, QARKU SHKODËR, Z. BARDH ALI SPAHIA, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Krerët II, pika 3, dhe V të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

V Ë R E J:

Me shkresën nr. 1075/1 prot., datë 27.03.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Zef Kin Hila, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Data: 12.4.2023 Nr: 317
Ora: 12:00



“Për shpalljen e mozgjedhshmërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, z. Bardh Ali Spahia., për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”

Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 02.03.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 410, datë 23.06.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021 dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur në zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Sipas vendimit të sipërcituar Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 5 (pesë) mandate dhe kandidat fitues nga lista shumemërore e Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim e Shqipërisë, për Qarkun Shkodër, janë numri rendor 01 (një) z. Helidon Skender Bushati, numri rendor 02 (dy) zj. Emilja Pjerin Koliqi, numri rendor 03 (tre) z. Ramadan Rexhep Likaj, numri rendor 04 (katër) zj. Greta Zef Bardeli, numri rendor 05 (pesë) z. Zef Kin Hila.

Rezulton se lista shumemërore e Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, për Qarkun Shkodër, miratuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 410, datë 23.06.2021, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor (5) z. Bardh Ali Spahia.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të pikës 3, të Kreut II, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, me shkresën nr. 2224 prot., datë 29.03.2023, i është drejtuar z. Bardh Ali Spahia, duke e njoftuar për depozitimin në KQZ të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Referuar pikës 3, të Kreut II, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, afati i fundit për depozitimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të formularit të vetëdeklarimit ishte data 7.4.2023.

Me shkresën nr. 2224/1 prot., datë 11.04.2023, kandidati për deputet z. Bardh Ali Spahia, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se nuk do të vijojë me procedurat ligjore përkatëse për marrjen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, pasi ka shprehur vullnetin të vijoj me ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Bashkisë.

Referuar nenit 5, pika 2 të ligjit nr.138/2015, mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjedhshmërinë e kandidatit si deputet i Kuvendit. Gjithashtu referuar Kreut II, pika 3, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se nuk pranon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Referuar nenit 11, pika 2 të ligjit nr. 138/2015, konstatohet se kandidati i rradhës në listën shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, për Qarkun Shkodër, nuk dorëzoi formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 164, pika 2 dhe 63 shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Krerët II, pika 3, dhe V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike -Aleanca për Ndryshim Qarku Shkodër, z. Bardh Ali Spahia.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI